



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk II.nr. 1321/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Faton Bajrami në çështjen përmbare të kreditorit N.P.T. “Euroni”, me numër biznesi 70001303 dhe seli në Fushë Kosovë, kundër debitorit K.R.M. “Pastrimi” Sh.A., me numër të biznesit 70465142 dhe seli në Prishtinë, rr. Bill Clinton, me bazë juridike përmbare, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr.2092/22 të datës 29.06.2023, me datë 05.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit K.R.M. “Pastrimi” Sh.A., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr. 2092/22 të datës 29.06.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2092/22 të datës 29.06.2023, ka Refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimi i debitorit K.R.M. “Pastrimi” Sh.A., me seli në Prishtinë ndaj Urdhrit Përmbare P.nr. 94/22, i lejuar me datë 23.03.2022, nga Përmbaresi Privat Eset Murati, dhe Urdhri Përmbare P.nr. 94/22, i lejuar me datë 23.03.2022, nga Përmbaresi Privat Eset Murati, mbetet ne fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr.2092/22 të datës 29.06.2023.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbare si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.P.T “Euroni ka paraqitur propozim për përbarim P.nr.94/22 të datës 23.03.2022, me të cilin ka lejuar përbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës nr. nr. F-21-350, e datës 16.02.2021, si dhe Faturës nr. F-21-3765, e datës 02.12.2021, ka lejuar urdhrin përbarimor P.nr. 94/22, të datës 23.03.2022, me të cilin është urdhëruar debitori që brenda afatit prej 7 ditësh pas pranimit të urdhrit, t’ia paguaj kreditorit shumën prej EUR 4,122.20, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e caktimi të përbarimit e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore aq sa do të krijohen deri në përbarim të plotë.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor me arsyetim se dokumente në bazë të së cilës është marr vendimi përbarues ose urdhëri përbarues, nuk janë të përshtatshme për përbarim dhe se të njëjtat janë fiktive dhe pa bazë juridike. Ka shtuar se me kreditorin kanë pasur marrëveshje mirëkuptimi për huazimin e përkoshem të kripës dhe pas zhvillimit të procedurave të prokurimit janë pajtuar që kripa t’i kthehet kreditorit i cili është njoftuar përmes telefonit për një gjë të tillë. Prandaj, debitori ka theksuar se mund të arrihet marrëveshja për kthimin e kripës së huazuar, ashtu që gjykatës i ka propozuar që palëve të ju ipet mundësia e arritjes së marrëveshjes. Për këto arsye, ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar. Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorit në prapësim nuk qëndrojnë, për faktin se propozimi për përbarim është i bazuar në dokument të besueshëm dhe në përputhje me neni 29 të LPP-së. Ka shtuar se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri janë pranuar nga debitori me datën 04.02.2022, dhe se nuk është bërë denoncimi i tyre. Në fund, ka shtuar se prapësimi i debitorit nuk mbështetet në asnjërën nga bazat nga neni 71 i LPP-së, dhe se debitori nuk ka ofruar prova për ti mbështetur pretendimet e tij në kuptim të nenit 69, paragrafi 4 të LPP-së, prandaj ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet dhe urdhri të mbete në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Shkalla e parë, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimi, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Gjykata e shkallës së parë vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumente të besueshme, përkatësisht Faturën nr. F-21-350, e datës 16.02.2021, si dhe Faturë nr. F-21-3765, e datës 02.12.2021, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në to janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij

Për më tepër, gjykata e shkallës së parë gjen se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarimor janë lëshuar me rregull nga ana e kreditorit dhe të njëjtat janë pranuar dhe protokolluara nga debitori. Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbarimor, i plotësojnë kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim në kopje të vërtetuara.

Tutje gjykata e shkallës së parë pati parasysh pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim i cili ka theksuar se me kreditorin kanë pasur marrëveshje për huazim të kripës dhe se pas përfundimit të procedurave të prokurimit, janë pajtuar që kreditorit t'i kthehet kripa e huazuar, mirëpo të njëjtat gjykata i gjeti si të pabazuar, ngase debitori nuk ka ofruar ndonjë provë për të vërtetuar këtë fakt, në kuptim të nenit 69, paragrafi 4 të LPP-së, me të cilin parashihet se: “Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”. Për më tepër, gjykata rikujton se kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përjashtimisht vlerësimi të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21 dhe 29 të LPP-së.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe ankesës se parashtruar ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejt kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit për përmbarimit.

Tutje dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit lidhur me pretendimin e tij se propozimi për përmbarim në bazë të dokumentit të

besueshëm nuk e përmban origjinalin apo kopjen e vërtetuar të dokumentit të besueshëm kundër urdhrin përmbartimor P.nr. 94/22, të datës 23.03.2022, me arsyetimin se ka pasur marrëveshjes interne përmes këtij prapësimi paraqesim mundësin e marrëveshjes për kthimin e kripës se mbetur pasi qe faturat e prezantuara nuk janë të pranuar nga debitori, mirëpo të njëjtat shkalla e dyte i gjeti si të pabazuar, ngase debitori nuk ka ofruar ndonjë provë për të vërtetuar këtë fakt, në kuptim të nenit 69, paragrafi 4 të LPP-së, me të cilin parashihet se: “Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”. Për më tepër, gjykata rikujton se kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përjashtimisht vlerësimi të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21 dhe 29 të LPP-së.

Andaj bazuar në të lartë cekurat, dhoma e shkallës së dytë vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë i bazuar. Më të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se debitori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K.Dh.Shk.II.nr. 1321/23 me datë 05.03.2024

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**